



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 33 datë 27.09.2019

***“PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL SIPËRMARRËSIT TELEKOM ALBANIA SH.A PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE BLOKU A3: 811-821 MHz (10 MHz) I ÇIFTUAR ME 852-862 MHz (10 MHz) TË BREZIT 800 MHz (790-862 MHz), TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHz (790-862 MHz), SPEKTËR I PAALOKUAR”, REF. 1X10 MHz I ÇIFTUAR-800-2019”, ZHVILLUAR NË AKEP DATË 09.09.2019”.***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>Z.</b>	<b>Ilir Zela</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Xhoana Lilaj</b>	<b>Anëtar</b>

dhe sekretare Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 27.09.2019, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr. 7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Miratimin e Autorizimit Individual sipërmarrësit Telekom Albania sh.a për përdorimin e frekuencave blloku A3: 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz) të brezit 800 MHz (790-862 MHz), të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz), spekter i paalokuar”, ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019, zhvilluar në AKEP datë 09.09.2019.***

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji 9918/2008**);
2. VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008, pikat 14.2, 14.3, 17.1, 17.2 dhe 21 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar (**VKM nr.1252**);
3. Ligji Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”, (**Ligji 44/2015**);
4. Dokumenti i tenderit miratuar me VKD nr. 28 date 01.08.2019 i ndryshuar.

### **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacion shpjegues mbi projekt-vendimin për miratimin e Autorizimit Individual sipërmarrësit Telekom Albania sh.a, i shpallur fitues për bllokun A: 811-821 MHz i çiftuar me 852-862 MHz, të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz), spektër i paalokuar*”, Ref. *1x10 MHz i çiftuar-800-2019*”, zhvilluar në AKEP datë 09.09.2019.
- Projektvendim i KD, i formatuar dhe arsyetuar;
- Shtojca 20 e dokumentit të tenderit (Autorizimi Individual);

Si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **VËREN:**

1. Në datën 09.09.2019, në AKEP u zhvillua procedura e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz), spektër i paalokuar*”, Ref. *1x10 MHz i çiftuar-800-2019*”.
2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përfundim të procedurës së vlerësimit, në përputhje me pikën 15.10, Kreu III të VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar, ka miratuar Raportin Përmbledhës me nr. 688/98 Prot. datë 20.09.2019 duke klasifikuar si ofertë të vlefshme ofertën e shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, për 1 (një) të drejtë përdorimi të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz) - bllokun A3 të frekuencave të brezit 800 MHz, me ofertë ekonomike **7 441 000 (shtatë milionë e katërqind e dyzet e një mijë) Euro**.
3. Bazuar në pikat 15.10 të Kreut III të VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 të ndryshuar, KVO paraqiti Raportin Përmbledhës për miratim në Këshillin Drejtues të AKEP.
4. Me Vendimin Nr. 32 datë 20.09.2019, në përputhje me përcaktimet e VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave” i ndryshuar dhe dokumentit të tenderit miratuar me VKD nr. 28 date 01.08.2019 i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar:
  - a. Raportin Përmbledhës të KVO-së me nr. 688/98 prot. datë 20.09.2019.

- b. Njoftimin e Fituesit shoqërisë Telekom Albania sh.a, për bllokun A3, 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz), të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz), sipas shtojcës 18 të dokumentit të tenderit;
  - c. Botimin e Fituesit, shoqëria Telekom Albania sh.a, për bllokun A3, 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz), të frekuencave të brezit 800 MHz (790-862 MHz), sipas shtojcës 19 të dokumentit të tenderit;
5. Me shkresën nr. 688/101 prot. datë 20.09.2019, sipërmarrësit Telekom Albania sh.a i është dërguar zyrtarisht njoftimi i fituesit, i cili përmbante të gjitha të dhënat e nevojshme për kryerjen e pagesës prej **7 441 000 Euro** në llogarinë e Qeverisë Shqiptare si dhe kryerjen e pagesave për AKEP dhe tarifën për shërbimet e radiokomunikacionit, sipas faturës së AKEP bashkëlidhur shkresës.
  6. Bazuar në pikat 14.2, 14.3, 17.1, 17.2 dhe 21 të dokumentit të tenderit, sipërmarrësi i shpallur fitues, përpara pajisjes me Autorizim Individual, duhet të shlyejë të gjitha pagesat e përcaktuara në dokumentin e tenderit, brenda 7 ditëve nga njoftimi i fituesit.

Sipërmarrësi Telekom Albania sh.a, rezulton të ketë shlyer të gjitha pagesat e përcaktuara në dokumentin e tenderit, përpara pajisjes me Autorizim Individual nga AKEP.

- d. Konkretisht me shkresën nr. 688/104 prot. datë 26.09.2019, Telekom Albania sh.a ka njoftuar në AKEP shlyerjen e pagesës **7 441 000 Euro** në llogarinë e Qeverisë Shqiptare. Gjithashtu, sipërmarrësi Telekom Albania sh.a, në datën 25.09.2019, ka kryer edhe pagesat për AKEP dhe pagesën për tarifën për shërbimet e radiokomunikacionit, referenca Raifeissen Bank: P1909251084IN00 datë 25.09.2019.
- e. Dokumenti i tenderit miratuar me VKD nr. 28 datë 01.08.2019, në Shtojcën nr. 20 përmban Autorizimin Individual me të cilin pajisjet operatori/subjekti që shpallet fitues në tender pasi shlyen paraprakisht të gjitha pagesat e përcaktuara në dokumentin e tenderit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

#### **Duke marrë në konsideratë:**

- VKM Nr. 1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave” i ndryshuar, pikat 19.2 dhe pikën 19.3 të Kreut III, si dhe pika 1 e Kreut IV;
- Dokumentin e Tenderit, miratuar me VKD nr. 28 datë 01.08.2019;
- VKD Nr. 32 datë 20.09.2019 “Mbi miratimin e raportit përmbledhës të KVO-së, Njoftimin e Fituesit dhe Botimin e Fituesit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 Mhz), spektër i paalokuar*”, ref. *1x10 MHz i çiftuar-800-2019*”.
- Shlyerjen brenda afateve të të gjithave pagesave nga sipërmarrësi Telekom Albania sh.a, të përcaktuara në dokumentin e tenderit, përpara pajisjes me Autorizim Individual nga AKEP;

dhe në zbatim të nenit 114 dhe nenit 115 të Ligjit nr. 9918/2008, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **VENDOSI:**

1. Të miratojë dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit Telekom Albania sh.a për përdorimin e frekuencave të bllokut A3: 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz) të frekuencave të brezit 800 MHz (792-862 MHz), sipas Shtojcës 20 të dokumentit të Tenderit, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky Autorizim Individual jepet me afatin maksimal për 15 vjet.
3. Ky Autorizim Individual fillon efektet e tij në datën 27.09.2019 dhe përfundon vlefshmërinë në datën 27.09.2034.
4. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve për njoftimin e këtij vendimi dhe dërgimin e Autorizimit Individual sipërmarrësit Telekom Albania sh.a.
5. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**Illir Zela**

**Ketrin Topçiu**

**Edlira Dvorani**

**Xhoana Lilaj**